

**UNITED  
NATIONS**

United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**UNMIK**

**NATIONS UNIES**

Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Ligjislatura e dytë**

Komisioni për Shëndetësi, Punë  
dhe Mirëqenie Sociale  
Nr. 30/2007

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së përbashkët të dy komisioneve : Komisionit për Shëndetësi ,Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisionit për Bujqësi ,Pylltar,Zhvillim Rural , Mjedis e Planifikim Hapësinor, mbajtur më 10.10.2007 sallën 301 C në orën 13,00**

**Të pranishëm:**

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Naim Jerliu, Shpresa Murati, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi ,Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi , anëtarë .

**Morën pjesë:**

Sadik Idriz ministër i Ministrisë së Shëndetësisë  
Flamur Kadriu Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit  
Çausht Kabashi –MBPZHR dhe  
Shefki Zeqiri , zyrtar ligjor i MBPZHR.

Takimin e drejtuan Lulëzim Zeneli dhe Fatmire Mulhaxha Kollçaku me këtë :

#### R e n d i t e

1. Takim i dy komisioneve i Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe i Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me harmonizimin e qëndrimeve në Projektligjin për ushqimin;
2. Shqyrtimi i Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

#### **Rendi i ditës u miratua.**

U hap shqyrtimi për pikën e parë

- 1. Takim i dy komisioneve, Komisionit për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe i Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me harmonizimin e qëndrimeve në Projektligjin për ushqimin**

**Kryesuesi Lulëzim Zeneli** i përshëndeti të pranishmit dhe nënvizoi se ky është takimi i dytë i dy komisioneve lidhur me gjetjen e mundësive të harmonizimit dhe të kapërcimit të pengesave që kanë të bëjnë me Projektligjin e ushqimit. Në vazhdim ceku se Komisioni për Bujqësi ka shqyrtuar amendamentet dhe e ka dhënë mendimin lidhur me to. Në vazhdim ceku, duke u bazuar në Rregulloren e nr. 2001/19 rregullohen kompetencat e Ministrisë së Bujqësisë që i takojnë dhe sipas tij do të ishte e preferueshme që seanca plenare të marrë qëndrim lidhur me divergjencat e dy komisioneve.

**Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** kryetare e Komisionit për Shëndetësi, i përsëriti qëndrimet e mëhershme të Komisionit për Shëndetësi të cilat kanë kundërthënë sa i përket formimit të Agjencionit ushqimit, me ato të Komisionit për Bujqësi, por do të bëjmë përpjekje që t'i zgjedhim pasi ne po hartojmë ligje për qytetarët e jo për organet. Në vazhdim ua përkujtoi takimin e mbajtur me kryetaret e komisioneve dhe nën drejtimin e kryetarit të kuvendit ku është kërkuar nga kryeministri që të japë mendim lidhur me vendosjen e Agjencionit dhe si përgjigje kemi marrë shkresën të cilën e kemi para vetes dhe vuri në pah që ky takim do të sjellë risi në afrimin e mospajtimeve.

**Sadik Idriz** ministër diskutoi lidhur me rëndësinë e projektligjet për ushqimin dhe apeloj se nëse komisionet mbeten në qëndrimet e tyre, të vendosë Kuvendit dhe nënvizoi se kjo do t'i mbetet Qeverisë së ardhshme, ndërsa lidhur me Agjencionin ne kemi bërë kompromis që të mbetet praninë e kabinetit të kryeministrit që nuk i përket as ministrisë së Shëndetësisë dhe as të Bujqësisë.

**Naim Jerliu** –kërkoi zgjedhje të drejtë dhe si GP i LDK-së nuk kemi dallime, kryesuesi në emër të kujt foli, pra është një vullnet i përgjithshëm për të proceduar që kjo të kapërcehet dhe shtoi: Të gjitha ndryshimet e bëra në Projektligj janë bërë nga ekspertët e jo nga Komisioni dhe tani e kemi qëndrimin e Qeverisë prandaj nuk dëshirojmë të krijohen situata konfliktuale

**Sevdije Halimi** ,anëtare e Komisionit për Bujqësi shprehi shqetësimin sesi Komisioni nuk jemi marrë vesh dhe iu kemi drejtuar Qeverisë edhe pas shtatë vjetësh nuk kemi rezultate në këtë fushë . Kjo rezulton nga ushqimi që na ofrohet që është gjenerator i këtyre sëmundjeve . Lidhur me vendimin e Qeverisë për Agjencionin së ushqimit se duhet të ishte profesional e jo politik duke kërkuar që Agjencioni i ushqimit të ishte borde ku do të kemi ekspertët të gjitha inspektorateve.

Ajo u propozoi komisioneve formimin e një grupi të punës nga dy komisionet dhe të punohet në këtë drejtim ne harmonizimin e qëndrimeve

**Shefki Zeqiri** nga Ministria e Bujqësisë nuk u pajtua me diskutimin e ministrit **Sadik Idriz** ku u cek se sponzoruesi nuk ka rëndësi lidhur me Projektligjin, ndërsa lidhur me qëndrimin e Kryeministrit vuri në pah se ai nuk është vendim nuk e obligon askënd por është një lloj rekomandimi

**Flora Brovina** – duke u ndërlidhur me parafolësit e ministrisë se bujqësisë shtroi pyetjen si mund të formohet Agjencioni kur nuk ekziston ligji dhe nënvizoi se nuk kanë pasur të drejtë të krijojnë Në vazhdim ceku se dy ministrit duhet të bashkëpunojnë ne mes veti dhe Agjencioni të mbetet në Kryeministri dhe shprehi habinë se si dy ministritë nuk kanë koordinim mes veti

**Çaush Kabashi** nënvizoi se Agjencioni i ushqimit është i themeluar me rregulloren nr. 2001/19 ,ku pjesa sanitare i është bashkangjitur Ministrisë së Bujqësisë Ai tha se kjo është bërë në pajtueshmëri me Rregulloren e BE nr. 178 . dhe ceku se këtë pëlqim ne kemi marrë nga ministri Sadik Idriz që të kalojë pjesa sanitare në Agjencionin e ushqimit .

**Nurishahe Hulaj** duke u ndërlidhur me parafolësit theksoi se argument pse kërkohet Agjencioni të vendoset ne Qeveri qëndron në indikatorët të analizuar në bazë të dhënave më se 50% e rasteve të sëmundjeve ngjitëse janë si pasojë e kontaminimit të ushqimit. Prandaj nuk jemi duke hartuar ligje për ministrit por për qytetaret e Kosovës.

**Berat Luzha** – vuri në pah se në Komisionin e Bujqësisë ka pasur vota të ndara lidhur me miratimin e amendamenteve dhe e përshëndeti qëndrimin e Qeverisë që Agjencioni të kalojë ne Kryeministri . Arsyetimin e mbështeti të vendoset aty ku është interesi i përbashkët dhe ligji do të ishte për qytetarët.

**Nafije Berisha** duke u ndërlidhur me parafolësit nënvizoi se 90% e Projektligjit është kopjim i shteti Kroat .Ajo u angazhua ne kapërcimin e kësaj gjendjes .

**Ferid Agani** duke u ndërlidhur me parafolësit ishte i mendimit se këtë Agjencion duhet ta kontrollojë Ministria e Shëndetësisë me organet që ka në bashkëpunim me ministrit e tjera . Ndërsa zgjidhja e ofruar e Qeverisë, sipas tij ,është zgjidhje kompromisi dhe nuk është të ishte në Qeveri pastaj diskuan: Çaush Kabashi ,Ferid Agani Naim Jerliu ,Sevdije Halimi dhe kjo doli si sugjerim që të dy komisionet se cila të rishikojnë amendamentet e veta dhe në fund të sugjerojë se a do të ketë nevojë për një takim të përbashkët.

Komisioni vendosi qe piken e dytë dhe e tretë të shqyrtohen ne mbledhjen e radhës .

**Mbledhja përfundoi në orën 14,30**

Procesmbajtës,  
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit  
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**

